



*Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së
organizatave të biznesit në Komunë*

Në bazë të nenit 40 të Ligjit nr. 2004/18 dhe plotësim ligji nr. 04/L-005 për tregtinë e brendshme si dhe Ligjit për Inspektimin e tregut 03/L-181 kreu i katërt pika 1.5, 1.6 si dhe Udhëzimit administrativ nr. 2007/03, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe format tjera të organizimit të tregtisë dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2011, miratoi

R R E G U L L O R E N

**PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË ORGANIZATAVE TË
BIZNESIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

I. DISPOZITAT E PËRGJTHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe të aktiviteteve tjera: hoteleri, zejтари dhe shërbime tjera të organizimit në territorin e komunës së Rahovecit.

Neni 2

Organizatave të biznesit, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

3.1 Orari i punës nënkupton periudhën kohore fillimin dhe mbarimin e punës.

3.2 Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.

II. Orari i punës

Neni 4

Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore, në intervale kohore:

- a. periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit;**
- b. periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit.**

Neni 5

5.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në dyqanet zejtare:

- a. periudha verore, prej orës 8:00 deri në orën 20:00;**
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 19:00.**

5.2. Gjellëtoret dhe qebaptoret punojnë çdo ditë pune:

- a. periudha verore, prej orës 6:00 - 23:00;**
- b. periudha dimërore prej orës 7:00 - 23:00.**

5.3. Ditën e fundjavës (të dielën) dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveç: gjellëtoreve, qebaptoreve, salloneve të ondulimit, floktoreve, autolarjeve dhe pikave të shitjes së shtypit ditor.

Neni 6

6.1. Orari i punës në vetëshërbime, supermarkete dhe dyqane ushqimore, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 - 23:00;**
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 23:00.**

6.2. Orari i punës në dyqanet tregtare të tekstilit, dyqanet e këpucëve, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake “teknikës së bardhë” dhe veprimtarive të tjera jo ushqimore, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 - 21:00;**
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 20:00.**

6.3. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni, do të ketë në ditën e fundjavës (të dielën) dhe ditët e festave, ku orari i punës do të fillojë në orën 8:00 dhe do të mbarojë në orën 12:00.

6.4. Organizatat e biznesit, sipas pikës 1 të këtij, që veprojnë në periferi të qytetit, në ditën e fundjavës (të dielën), mund të punojnë me orar të zgjatur edhe pas orës 12:00, me pëlqim të veçantë të lëshuar nga Sektori i ekonomisë i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 7

7.1. Orari i punës në depot e artikujve ushqimorë, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 8:00 - 20:00;**
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 18:00.**

7.2. Ditën e fundjavës (të dielën) dhe gjatë ditëve të festave, depot nuk punojnë.

7.3. Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë), do të jetë:

a. periudha verore, prej orës 7:00 - 18:00.

b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 17:00.

7.4. Ndërmarrjet ndërtimore, në raste të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës së punëve, me leje të posaçme, të cilën e lëshon Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit - Sektori i ekonomisë, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00.

Neni 8

8.1 Orari i punës në kafene do të jetë:

a. periudha verore, prej orës 7:00 - 24:00;

b. periudha dimërore, prej orës 08:00 - 23:00.

8.2. Orari i punës në hotele, motele dhe restorante është i njëjtë në të dy sezonet dhe fillon prej orës: 7:00 - 24:00.

8.3. Përfundim nga pika 2 e këtij neni do të ketë, sepse mund të punojnë më gjatë se orari i paraparë i punës, por jo më shumë se deri në orën 3:00 të mëngjesit. Për këtë duhet të kërkohet leje e veçantë, të cilën e lëshon Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit - Sektori i ekonomisë. Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, 100 € për orë pune. Përfundimi i pagesës së kësaj takse bëhet me rastin e organizimit të ahengjeve familjare dhe institucionale ku pagesa a e taksës shtesë do të jetë 10 €.

8.4. Veprimtarive të lartpërmendura në piken 2 të këtij neni, nuk iu lejohet shërbimi për mysafirë jashtë objektit pas orës 24:00.

8.5. Në bazë të rrethanave të krijuara emergjente dhe në rast të ndonjë rekomandimi nga organet e punëve të brendshmeve, oraret e punës pas 24 orë, nuk vlejnë në asnjë veprimtari.

Neni 9

9.1. Orari i punës në kafe - bare dhe disko klube, është i njëjtë për të dy sezonet, fillon në orën 20:00 dhe mbaron në orën 3:00 (të mëngjesit).

9.2. Orari i punës për klubet e natës është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 23:00 dhe mbaron në orën 5:00 (të mëngjesit).

9.3. Orari i punës për internet - kafe dhe bastore fillon në orën 8:00 dhe mbaron në orën 23:00.

Neni 10

Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat sportive punojnë pa kufizime.

Neni 11

Veprimtarive të parapara në nenet 8, 9 dhe 10 të kësaj Rregulloreje gjatë orarit të punës, nuk iu lejohet t'u prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria.

Neni 12

12.1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve është:

a. periudha verore, prej orës 02:00 - 19:00, ndërsa tregjet e gjelbërta ku tregtia e pemëve dhe perimeve bëhet me shumicë, orari i punës është 24 orë.

b. periudha dimërore, prej orës 7:00 - 18:00.

12.2. Tregu i gjelbër nuk do të punojë gjatë ditës së fundjavës (të dielën) dhe ditëve të festave.

12.3. Tregu i kafshëve punon një ditë në javë (ditëve të tregut të caktuara në lokalitete), ndërsa tregu i automjeteve një ditë në javë.

Neni 13

Në objektet hoteliere, të cilat gjenden në afërsi deri në 100 m nga objektet e banimit, në të cilat organizohet program me muzikë të gjallë apo me audio - video mjete për reproduktimin e programit, programi nuk mund të vazhdojë pas orës 24 : 00.

Neni 14

Orari i punës në pikat e shitjes së karburanteve gjatë sezonit të verës është nga 06:00 deri në orën 24:00. Orari i dimrit është nga ora 06:00 deri në ora 22:00.

Orari i punës në pikat e shitjes së karburanteve mund të kenë orarin edhe 24 : 00 (pa ndërprerë), pa nevojë të pagesës për orarin shtesë.

Neni 15

15.1. Orari i punës në barnatore, ordianca dhe klinika private do të jetë i njëjtë në të dy sezonet, fillon në orës 7:00 dhe mbaron në orën 22:00.

15.2. Në raste urgjente, të dielave dhe gjatë festave shtetërore, mund të punojnë edhe jashtë orarit të paraparë sipas paragrafit 15.1.

15.3. Barnatoret që veprojnë në qytet në afërsi të shërbimeve mjekësore me qëllim të përmbushjes së nevojave të qytetarëve, janë të obliguara të kujdestarojnë me radhë.

15.4. Orarin në formë të shkruar e cakton Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, sipas të alfabetit të mbishkrimeve të barnatoreve. Orari i kujdestarisë caktohet për një muaj.

15.5. Orari i kujdestarisë duhet të caktohet në të gjitha barnatoret të cilat kujdestarojnë dhe në Shërbimin e Urgjencës në Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Neni 16

- 16.1. Organizatat e biznesit mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave, të parapara me Ligjin për festat zyrtare dhe kombëtare, deri në orën 01:00 (të mëngjesit).
- 16.2. Për të gjitha rastet e parapara në piken 1 të këtij neni, nuk paguhet taksa shtesë.

III. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 17

Të gjitha organizatat e biznesit të cilat nuk e respektojnë orarin e punës të caktuar nga kjo Rregullore si dhe të subjektet afariste tek të cilat konstatohet se e kanë zgjatur orarin e punës pa miratimin e lëshuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, do të gjobiten me dënim mandator prej 50 €, ose kundërvajtje dhe atë:

1. Dënimi i parë 250 €
2. Dënimi i dytë 500 €
3. Hera e tretë pason me mbylljen e lokalit.

Për mos zbatimin e dispozitave nga paragrafi paraprak të kësaj Rregulloreje, personi përgjegjës në personin juridik të kësaj organizate do të gjobitet me 150 €.

Për rihapjen e lokalit përveç dënimit të cekur subjekti duhet të paguaj edhe shpenzimet administrative në vlerë prej 100 €.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 18

Të gjitha organizatat e biznesit për brenda territorit të Komunës së Rahovecit janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 19

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, Inspektori i Tregut në bashkëpunim me Policinë e Kosovë, ndërsa procedurën e kundërvajtjes do ta zhvilloj Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Rahovec.

Neni 20

Me hyrje në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Rahovecit 01 nr. 134 e datës 21.05.2004 dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores e kësaj rregullore 01 Nr. 110 të datës 21.07.2006.

Neni 21

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. 4536
Rahovec, më 14. 11. 2011

KRYESUESI I KUVENDIT

Kujtim Popaj